

SONILA BOÇI

**MINORITETI GREK NË SHQIPËRI
NË FILLIM TË VITEVE '50**

**Situata politike në Shqipëri në fund
të viteve '40 dhe minoriteti grek**

Fundi i viteve '40 pati ndryshime të rëndësishme në situatën e brendshme dhe të jashtme të shtetit shqiptar. Në marrëdhëniet ndërkombëtare, lufta civile në Greqi kishte përfunduar me fitoren e Bllokut Perëndimor, por kriza e Berlinit shënoi një pikë të re kulmore në Luftën e Ftohtë. Ndërkohë, në Bllokun Lindor, Jugosllavia e Titos i tha “jo” diktatit të Bashkimit Sovjetik, duke shënuar kështu ndarjen e parë në të.

Këto ngjarje ndërkombëtare patën rezonancën e tyre në Shqipërinë e vogël. Një sërë ndryshimesh u vunë re në politikën e brendshme dhe të jashtme shqiptare, të cilat, në mënyrë të natyrshme, ndikuan dhe në politikën e shtetit shqiptar ndaj minoritetit grek. Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë përparësitë dhe mangësitë që pati minoriteti grek në Shqipëri nga zhvillimet e brendshme dhe situata ndërkombëtare.

Së pari, ndryshoi rëndësia strategjike e Shqipërisë. Pas përfundimit të luftës civile në Greqi me fitoren e të djathtës dhe me shkëputjen e Jugosllavisë nga Blloku Lindor, Shqipëria u bë barriera e parë, kufiri ekstrem mes Perëndimit dhe Lindjes, duke fituar një rëndësi të madhe strategjike¹. Në këtë situatë, minoriteti grek në Shqipëri, i cili ishte vendosur në rajonin kufitar mes Shqipërisë dhe Greqisë mori një rëndësi të madhe.

Së dyti, ndryshuan aleatët. Në Kongresin I të PKSH të mbajtur nga datat 8-22 nëntor 1948, Enver Hoxha deklaroi Bashkimin Sovjetik si aleatin e madh të popullit shqiptar. Kjo do të thoshte se koha e “vëllazërimit mes popullit shqiptar dhe atij jugosllav” kishte përfunduar. Tashmë udhëheqësi komunist, i cili kishte marrë dhe flamurin e mbrojtjes së pavarësisë së shtetit nga intrigat jugosllave, do të përpiqej ta

¹ Central Intelligence Agency (CIA), doc. 235066, *The current situation in Albania*, publikuar më 17 dhjetor 1949, f. 3.

shfrytëzonte këtë në interes të pushtetit të tij. Enver Hoxha kishte shumë arsye t'i thurte lavde Bashkimit Sovjetik².

Ky ndryshim aleatësh solli dhe një ndryshim në konceptin inter/nacionalist të komunisteve shqiptarë. Enver Hoxha filloi t'i referohej gjithnjë e më shumë patriotizmit të shqiptarëve³. Por, patriotizmit iu dha një kuptim të veçantë dhe disi të çuditshëm: “Në bazën e patriotizmit të popullit tonë është dashuria dhe besnikëria ndaj Bashkimit Sovjetik, ndaj Partisë Bolshevike dhe shokut të madh Stalin”⁴. Sipas Enver Hoxhës, të gjithë ata që nuk i kishin të qarta ose i luftonin “këto principe të patriotizmit të vërtetë, janë armiq të popullit dhe shërbëtorë të imperialistëve skllavëronjës”⁵. Këtë lloj patriotizmi, drejtuesit komunistë ua imponuan të gjithë shtetasve shqiptarë, pra dhe minoriteteve. Por, ndërsa shqiptarëve u kërkohet t'ia dedikonin besnikërinë e tyre si shtetit të tyre, ashtu dhe “atdheut të socializmit botëror”, për minoritetin grek, ky lloj patriotizmi donte të thoshte se ai duhet të luftonte shtetin e tij amë dhe të besonte, madje dhe të glorifikonte Bashkimin Sovjetik.

Fundi i viteve '40 solli ndryshime edhe në planin e brendshëm. Prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë radikalizoi dhe më tej politikën e komunistëve shqiptarë. Në raportin e tij në Kongresin I të PPSH, Enver Hoxha pranoi se nën shtytjen e jugosllavëve dhe përkrahësve të tyre në Byronë Politike të KQ të PKSH, vija politike e saj gjatë viteve 1944-1948, kishte qenë përgjithësisht e gabuar⁶. Enver Hoxha gjeti me këtë rast, fajtorë për problemet e shumta ekonomike dhe dhunën e ushtruar ndaj popullsisë shqiptare gjatë viteve 1944-1948. Madje, për të siguruar shqiptarët se situata do të ndryshonte, KQ i PPSH i udhëzoi drejtuesit

² Rezolucioni i Informbyrosë, i cili u botua në gazetën “Bashkimi” më 29 qershor 1948, shpalli prishjen e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Ky rezolucion u parapri nga tre letra që KQ i PKP(b) të Bashkimit Sovjetik ia kishte dërguar të gjitha partive komuniste, midis të cilave dhe PKSH. Për më tepër mbi këtë çështje shih: Ana Lalaj, “Shqipëria e Informbyroja”, në *Studime historike*, 3-4, 2009, f. 103-129.

³ Enver Hoxha përdorte termin “patriotizëm” dhe jo “nacionalizëm”, pasi ky i fundit ishte barazuar me shovinizmin. Enver Hoxha, mesa duket, nuk pranonte t'i bëhej ndonjë referim negativ për nxitjen e nacionalizmit të shqiptarëve të Kosovës.

⁴ *Kongresi I-rë i Partisë Komuniste të Shqipërisë (8-22 nëntor 1948)*, botim i Partisë së Punës së Shqipërisë, Tiranë: 1950, Nga raporti i Enver Hoxhës mbajtur para këtij kongresi, f. 18.

⁵ *Po aty.*

⁶ *Po aty.*

lokalë në të gjitha rrethet, të organizonin mbledhje dhe konferenca të ndryshme, ku populli të thoshte pakënaqësitë e tij për mënyrën si po qeverisej. Nga kjo fushatë, si pjesë integrale e shtetit shqiptar, nuk mund të shpëtonin dhe minoritetet, e veçanërisht ai grek.

Në fillim të vitit 1949, kur rezolucioni i Kongresit të I të PPSH filloi të punohej dhe në krahinat ku banonte minoriteti në qarkun e Gjirokastrës, popullsia e krahinës, ashtu si të gjithë shqiptarët, e përjetuan atë si një periudhë të shkurtër frymëmarrjeje. Në raportin e muajit janar 1949, komiteti i PPSH i rrethit të Gjirokastrës njoftoi se pjesëmarrja e popullit në konferencat e mbledhura për këtë qëllim kishte qenë shumë e lartë⁷. Një pjesëmarrje e tillë ishte e kuptueshme. Këto krahina, ashtu si dhe pjesa tjetër e qarkut të Gjirokastrës, gjatë periudhës 1944-1948, ishin përballur me vështirësi ekonomike. Është e vërtetë se minoriteti grek kishte përfituar tokë nga Reforma Agrare. Por, nga ana tjetër, minoritarët grekë kishin humbur dy burime financiare jo të vogla: ishin ndërprerë subvencionet ekonomike që merrnin nga Greqia, si dhe ishin ulur ndjeshëm paratë që vinin nga emigracioni ekonomik. Si rezultat, standardi ekonomik i minoritarëve grekë kishte rënë në krahasim me periudhën mes dy luftërave. Sikur të mos mjaftonin vështirësitë ekonomike, minoriteti grek, ashtu si dhe shumica shqiptare, kishin provuar keqqeverisjen dhe arbitraritetin e shtetit komunist.

Propaganda e zhvilluar gjerësisht gjatë dhe pas kongresit e bëri punën e vet. U duk për një fraksion kohe, se situata politike mund të përmirësohej. Madje, një pjesë e madhe e popullsisë shqiptare, e gënjyer nga kjo propagandë, ngriti zërin për të evidentuar keq menaxhimin e pushtetit gjatë viteve 1944-1948. Sipas raportit të komitetit të partisë së qarkut të Gjirokastrës edhe populli i minoritetit, veçanërisht në zonën kufitare, si: në Pogon dhe në Dropullin e Sipërm, pati guximin të shprehej lirshëm edhe të kritikonte organet qeverisëse duke i konsideruar ato shkaktare të problemeve të shumta ekonomike, si: furnizimin jo të rregullt, klasifikimin e gabuar të tokave etj. Në Dropullin e Sipërm ngritën me forcë nevojën për lirin e fushës së Bularatit, e cila ishte minuar nga ushtria. Popullsia e këtyre krahinave minoritare u ngrit dhe

⁷ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi 14/Arkivi i PPSH (më tej: AP) (strukturë), viti 1949, dos. 291, Raport për muajin janar 1949 të Komitetit të Partisë së rrethit Gjirokastrë për KQ të PPSH, nr. 31 sekret, 1 shkurt 1949.

kritikoi edhe Sigurimin e Shtetit, “për sjelljet e tyre brutale, arrogancën, torturat dhe sjelljet e tyre bajraktare”⁸.

Siç e treguan qartazi ngjarjet e mëvonshme, qeveria komuniste shqiptare nuk kishte qëllim të zbuste “diktaturën e proletariatit”. Ajo ishte në kërkim të një fajtori për vendimet politike të gabuara, apo dështimet e reformave të ndërmarra prej saj në katër vjet. Qëllimi kryesor i PPSH ishte të forconte diktaturën dhe të fuqizonte mjetet me të cilat ushtrohej ajo. Jo më kot, Enver Hoxha, në raportin e tij në Kongresin e I të PPSH dhe Rezolucionin që u botua pas tij, theksoi me forcë mbështetjen e PPSH për Sigurimin e Shtetit, si “arma e mprehtë dhe e dashur e Partisë sonë, pasi ajo mbron interesat e popullit dhe të Partisë kundër armiqvet të brendëshëm dhe të jashtëm”⁹.

Në raportet e shumta të komitetit të PPSH për rrethin e Gjirokastrës dhe Sarandës, kuptohet se konferencat e shumta kishin për qëllim të dënonin veprimtarinë e Koçi Xoxes, madje edhe të spastronin organet lokale nga mbështetës të tij. Thelbi i diktaturës nuk kishte ndryshuar për sa kohë që drejtuesit lokalë njoftonin me shqetësim qendrën e tyre se “pas rezolucionit në Pogon, Dropulli i Sipërm, shokët [komunistët] u pa të humbasin kurajon dhe të zbusin luftën e klasave në fshat dhe veçanërisht në Rrëzë të Zezë armiku të hidhet në sulm dhe ... hidhnin parulla me tendenca shoviniste “duam shtyp të lirë”. Shokët tanë para kësaj gjendjeje janë të ftohtë dhe pa kurajo për të luftuar”¹⁰.

Qëllim tjetër i drejtuesve të lartë komunistë ishte të vazhdonte ideologjizimi komunist i të gjithë shtetasve shqiptarë, përfshirë dhe minoritetin duke i detyruar ata të përqafonin “patriotizmin socialist”, që po i imponohej.

Zyrtarizimi i politikës së shtetit shqiptar ndaj minoritetit grek

Në fund të vitit 1949, dy ngjarje të ndodhura në dy fshatra të banuara nga minoritarë grekë: Goricë dhe Glinë, tronditën drejtuesit më të lartë politikë në vend. Më 31 dhjetor 1949 në fshatin Goricë të Dropullit të Poshtëm, banorët e fshatit u konfrontuan me forcat e ushtrisë. Disa ditë më vonë, një ngjarje e ngjashme ndodhi dhe në një fshat tjetër

⁸ *Po aty.*

⁹ *Kongresi I-rë i Partisë Komuniste të Shqipërisë ...*, f. 200.

¹⁰ *AQSh*, Fondi 14/AP (strukturë), viti 1949, dos. 291, Raport për muajin janar 1949 të Komitetit të Partisë së rrethit Gjirokastrë për KQ të PPSH, nr. 31 sekret, 1 shkurt 1949.

të minoritetit, në Glinë. Në pamje të parë, të dyja protestat kishin karakter ekonomik. Sipas planifikimit shtetëror, rrethi i Gjirokastrës duhet të strehonte një numër të madh bagëtish, të cilat e tejkalonin kapacitetin e kullotave në këtë rreth. Komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të qarkut Gjirokastrë, i vënë nën presion, u detyrua t'i shpërndante bagëtitë e caktuara në të gjitha fshatrat e rrethit, midis të cilave dhe në ato që banoreshin nga minoriteti grek.

Kur tufat e çobanëve arritën në fshatin Goricë, në krahinën e Rrëzës së Zezë, gratë e fshatit i sulmuan ato. Drejtuesit lokalë u përpoqën t'i jepnin situatës karakter politik, duke theksuar se “demonstrata e grave” ishte organizuar nga dy elementë shovinistë, Thodhori Qirici dhe Koço Pasko, të cilët kishin gjetur mbështetjen dhe të disa prej komunistëve të fshatit. Në të vërtetë protesta e grave nuk pati as parulla politike, dhe as nacionaliste¹¹. Drejtuesit e PPSH në qarkun e Gjirokastrës u treguan të kujdesshëm me menaxhimin e situatës. Sekretari i komitetit të partisë, Koço Nika për të shmangur dërgimin e forcave të armatosura dhe për të sqaruar situatën dërgoi Vasil Dalanin, një minoritar, i cili ishte funksionar i komitetit të partisë së rrethit. Vajtja e tij nuk e përmirësoi situatën. Ai nuk arriti të gjente ndonjë kompromis me fshatarët, të cilët ishin të vendosur të mos lejonin barinjte e zonave të tjera, aq më pak ata shqiptarë, në kullotën e fshatit të tyre. Madje për ta treguar këtë, ata prishën kullotën e fshatit.

Dy ditë pas ngjarjes së Goricës një protestë e ngjashme, po më e fuqishme shpërtheu në Glinë, një fshat tjetër i banuar nga minoritarë grekë. Banorët e Glinës morën shkas nga problemi i kullotave për t'i dhënë protestës së tyre karakter politik. Banorët hodhën parulla kundër qeverisjes komuniste, kundër ligjeve të shtetit komunist e veçanërisht kundër sistemit të ri të grumbullim-furnizimit, si dhe kundër PPSH dhe Enver Hoxhës. Në përshkallëzimin e protestës së Glinës, mendoj se një rol të rëndësishëm duhet të ketë luajtur dhe sjellja deri diku e butë e organeve partiake dhe shtetërore lokale në protestën e banorëve të Goricës.

Mesa e treguan ngjarjet, drejtuesit komunistë lokalë nuk kishin ndërmend të përsërisnin të njëjtin “gabim” si në protestën e Goricës.

¹¹ *Po aty*, Fondi 14/AP (strukturë), viti 1950, dos. 192, fl. 1, Raportim i Komitetit të PPSH të rrethit të Gjirokastrës rreth ngjarjeve të ndodhura në fshatrat Goricë dhe Glinë, 11 janar 1950.

Përkundrazi, në Glinë u dërguan forca të shumta ushtarake e policore, të cilat u konfrontuan me popullsinë e zonës. Si masë ndëshkimore organet e policisë dhe Sigurimit të Shtetit arrestuan të gjithë burrat e Glinës. Ngjarja pati jehonë dhe filloi të diskutohej në të gjithë zonën minoritare. Ajo shqetësoi dhe i vuri në lëvizje të gjithë mekanizmat partiake si lokalë, ashtu dhe qendrorë. KQ i PPSH i kërkoi komitetit të partisë të Gjirokastrës një raport të detajuar, ndërkohë Vasil Mici, një nga instruktorët e drejtorisë së organizimit të KQ, u dërgua të vëzhgonte situatën në vend.

Raportet e dërguara në KQ të PPSH nga Subi Bakiri, sekretar i komitetit të PPSH për Gjirokastrën dhe inspektori Vasil Mici, nuk mendonin se çështja duhet të trajtohej me karakter thjesht ekonomik. Në raportin e V. Mici fajësoheshin drejtuesit e komitetit ekzekutiv të Gjirokastrës për marrjen e një mase të gabuar në lidhje me kullotat. Por edhe ai kishte të njëjtin mendim me komitetin e PPSH të Gjirokastrës, se protestuesit e Glinës vetëm kishin “shfrytëzuar pretekstin e barit [kullotave] duke e lidhur këtë me problemet ekonomike dhe politike”¹². Ato ishin gjithashtu në të njëjtën linjë në përcaktimin e organizatorëve, të cilët, sipas tyre, ishin “elementa shovenë”, të cilët kishin gjetur dhe mbështetjen e anëtarëve të partisë së zonës¹³. Në të dyja raportet Glina konsiderohej si një rajon, i cili nuk e kishte mbështetur asnjëherë PPSH dhe “pushtetin popullor”¹⁴. Glinjotët, - theksonte raporti i Vasil Micit, - kishin qenë gjithmonë indiferentë ndaj PKSH/PPSH, si gjatë LANÇI-it, ashtu dhe më pas. Aty kishte pasur ndikim shumë të fuqishëm konsullata greke, ndërmjet agjentit të saj, Vasil Shahinit dhe këto tendenca shoviniste vazhdonin të ishin të theksuara në këtë fshat¹⁵. Edhe për Subi Bakirin ngjarja e Glinës “lidhet ngushtë me shovinizmin që karakterizon gjithë fshatin, me lidhjet që ka pasur Glina me Vasil Shahinin [...], me lidhjet që ka dhe tani fshati me monarko-fashizmin grek dhe me

¹² *Po aty*.

¹³ *Po aty*, Fondi 14/AP (strukturë), viti 1950, dos. 192, fl. 1, Raportim i Komitetit të PPSH të rrethit të Gjirokastrës rreth ngjarjeve të ndodhura në fshatrat Goricë dhe Glinë, 11 janar 1950, si dhe *AQSh*, Fondi 14/AP organet udhëheqëse, viti 1950, dos. 20, fl. 3/1, Nga raporti i paraqitur nga Vasil Mici, instruktor i KQ.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ *AQSh*, Fondi 14/AP (organet udhëheqëse), viti 1950, dos. 20, fl. 3, Nga raporti i paraqitur nga Vasil Mici, instruktor i KQ.

presionin e tij, pasi fshati është pranë kufirit”¹⁶. Sipas tij, një shkak tjetër ishte mos ndërhyrja e policisë në demonstratën e Goricës¹⁷. Në raportin e tij, Vasil Mici shkante dhe më larg, ai e konsideronte ngjarjen e Glinës “vetëm një shfaqje të punës armiqësore t’elementit shovinist dhe armik në minoritet”¹⁸.

Nga sa u përmend më sipër, duket qartë se drejtuesit komunistë mendonin për një situatë të paramenduar, madje dhe implikime të agjencive të huaja të zbulimit. Nga dokumentacioni që disponoj është e pamundur të thuhet nëse ngjarja ka qenë e paramenduar, apo për më tepër nëse ka ndonjë të vërtetë mbi përfshirjen në këto ngjarje të zbulimit të vendeve fqinjë apo atij perëndimor. Dokumentet greke mungojnë plotësisht, ndërsa ato shqiptare duhen trajtuar me kujdes. Në këto kushte gjithçka që mund të bëjmë, është të ngremë disa hipoteza, në bazë të fakteve të njohura.

Situata në marrëdhëniet shqiptaro-greke, pas përfundimit të Luftës Civile, vazhdonin të ishin të acaruar. Në vjeshtë-dimër të vitit 1949, Shqipëria u ndodh në një pozitë të vështirë përballë kërcënimit grek¹⁹. Në këtë situatë, nuk mund të përjashtohet që ngjarja e Glinës mund të ketë qenë një test për qëndrimin e qeverisë shqiptare ndaj minoritetit grek, apo edhe një pretekst për të përligjur një ndërhyrje ushtarake të Greqisë.

Nga ana tjetër, është i njohur fakti se qeveritarët komunistë i referoheshin armiqve të shtetit apo të pushtetit sa herë që situata nuk ishte plotësisht nën kontroll. Në rastin e minoritetit grek, çdo njeri që i kundërshtonte politikisht, apo thjesht ngrinte zërin për një veprim të gabuar të drejtuesve komunistë, etiketohej si shovinist. Pa dashur të përjashtoj nacionalizmin, ndonjëherë të skajshëm të disa rajoneve minoritare, jam e detyruar të bëj disa konstatime.

Në të dy protestat nuk pati shfaqje nacionalizmi, dhe aq më pak separatizmi. Protesta e banorëve të Goricës lidhej vetëm me kullotat, ndërsa banorët e Glinës, duke marrë shkas nga çështja e kullotave,

¹⁶ *Po aty*, Fondi 14/AP (strukturë), viti 1950, dos. 192, fl. 1, Relacion rreth ngjarjeve të ndodhura në fshatrat Goricë dhe Glinë dërguar nga komiteti i PPSH i rrethit Gjirokastrës, KQ të PPSH, 11 janar 1950.

¹⁷ *Po aty*.

¹⁸ *AQSh*, Fondi 14/AP organet udhëheqëse, viti 1950, dos. 20, fl. 3, Nga raporti i paraqitur nga Vasil Mici, instruktor i KQ.

¹⁹ Beqir Meta, *Shqipëria dhe Greqia 1949-1990, Paqja e vështirë*, Tiranë: Botimet “Koçi”, 2004, f. 50.

artikuluhan pakënaqësi ndaj politikës ekonomike të shtetit shqiptar. Qeveria shqiptare kishte krijuar mundësi për shkollimin e minoritetit grek në gjuhën amtare, si dhe mundësi për pjesëmarrjen e anëtarëve të minoritetit në të gjitha nivelet e administratës shtetërore dhe partiake. Por, politikat e gabuara ekonomike të shtetit shqiptar e sidomos izolimi i vendit kishte krijuar mjaft vështirësi ekonomike për banorët.

Dokumentet eidentojnë qartazi situatën e vështirë ekonomike dhe politike gjatë vitit 1949 në të gjithë rrethin e Gjirokastrës e, midis krahinave të tjera, edhe në fshatrat minoritare. Toka në rrethin e Gjirokastrës nuk ishte e mjaftë. Një pjesë e tokave të kufirit ishin marrë nga ushtria dhe ishin minuar²⁰. Sistemi i ri i grumbullim furnizimeve, i krijuar enkas për të moslejuar pasurimin e fshatarëve, kishte shkaktuar vështirësi të shumta ekonomike në këtë rajon. Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, viti 1949 kishte pasur korrije të pakta, për shkak të motit të keq. Ndërkohë minoritetit i ishte prerë mundësia të përfitonte nga paratë e emigrantëve ekonomikë jashtë vendit, të cilët kishin qenë burimi kryesor i të ardhurave për këtë zonë. Vështirësitë ekonomike dhe papunësia e madhe kishin shkaktuar natyrshëm dhe pakënaqësinë e minoritetit grek ndaj qeverisë komuniste.

Në komunikimet e vazhdueshme të drejtuesve lokalë, si atyre partiakë, ashtu dhe shtetërore, vihej në dukje se në gjitha krahinat minoritare po shtoheshin tendencat për t'u arratisur nga Shqipëria. Pakënaqësia e banorëve të krahinave minoritare ndaj qeverisjes komuniste u shpreh dhe në zgjedhjet e këshillave popullorë të fshatrave, të zhvilluara më 5 dhe 12 qershor 1949. Në këto zgjedhje në 30 fshatrat e minoritetit që gjendeshin në rrethin e Gjirokastrës kishte pasur 497 vota në kutinë pa kandidat, ndërkohë që në disa fshatra si Bularat, Glinë, Dhivër gati gjysma e fshatit kishte votuar kundër kandidatëve zyrtarë²¹. Gjithashtu, një numër i banorëve të fshatrave minoritare kishin abstenuar²². Për të gjitha këto arsye, unë prirem të besoj se dy ngjarjet mund të kenë qenë reagime spontane të banorëve, të diktuar nga situata ekonomike.

²⁰ *AQSh*, Fondi 14 strukturë, viti 1949, dos. 62, fl. 5-7, Protokoll i mbledhjes së byrosë së Komitetit të Partisë së rrethit të Gjirokastrës mbi përfundimin e zgjedhjeve të Këshillave të Frontit, 7 qershor 1949.

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty*.

Situata në Glinë shqetësoi nivelet më të larta partiake dhe shtetërore të Shqipërisë. Edhe më herët, qeveria shqiptare kishte qenë shumë e vëmendshme kur bëhej fjalë për minoritetin grek, por situata politike në fund të vitit 1949 dhe në fillim të vitit 1950 nuk mund të lejonte asnjë indiferentizëm. E vendosur mes Jugosllavisë së Titos dhe qeverisë pro-amerikane në Greqi, qeveria e Enver Hoxhës e ndjente veten në mes dy zjarresh. Për më tepër, Enver Hoxha kishte njoftime për organizimin e një operacioni nga ana e Perëndimit me qëllim rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri. Ai nuk dinte kohën, nuk dinte as mënyrën sesi ky operacion do të zhvillohej, por kishte njoftime për të²³. Më 15 janar 1950, përfaqësuesi shqiptar në OKB, Behar Shtylla njoftonte ministrinë e jashtme dhe atë të brendshme se “agjentë greko-amerikanë organizojnë arratisjen e familjeve nga fshatrat tona të Jugut në Greqi e së andejmi në Amerikë”²⁴. Enver Hoxha, si pragmatist që ishte, e kuptonte se minoriteti mund të shndërrohej në thembrën e Akilit të qeverisjes së tij. Shqetësimin e drejtuesve komunistë e shtonin dhe qëndrimi i krahinave të tjera minoritare ndaj ngjarjeve të Glinës. Shumë pak prej tyre e kishin dënuar atë, pjesa më e madhe ose kishin mbajtur qëndrim indiferent, ose kishin mbështetur ngjarjet e ndodhura në Glinë²⁵. Arrestimet në masë kishin ngjallur psikozën e frikës në të gjithë banorët e zonës, por përsëri popullsia e minoritetit gjente mënyra për të shfaqur pakënaqësinë e saj. Në Dropullin e Sipërm banorët, si protestë për gjendjen e vështirë ekonomike, nuk i dërgonin fëmijët në shkollë²⁶. Situata mund të bëhej problematike, prandaj drejtuesit më të lartë komunistë kishin vendosur t’i jepnin ngjarjes vëmendjen e duhur.

Më 28 janar 1950, Byroja Politike e KQ të PPSH, shfrytëzoi ngjarjen e Glinës për të bërë një analizë mbi situatën ekonomike dhe politike në minoritetin grek. Ishte hera e parë, që nga ardhja e komunistëve në pushtet, që gjendja në minoritetin grek diskutohej në një nivel kaq të lartë partiak. Ajo zyrtarizoi linjat politike të qeverisjes

²³ Jussi Hanhimaki & Odd Arne Westad, *The Cold War, a history in documents and eyewitness account*, Oxford University Press, 2003, fl. 314.

²⁴ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti 1950, dos. 200, fl. 2, Telegram i Behar Shtyllës për MPJ dhe për dijeni MPB, 15 janar 1950.

²⁵ *AQSh*, Fondi 14/AP organet udhëheqëse, viti 1950, dos. 20, fl. 3/1, Nga raporti i paraqitur nga Vasil Mici, instruktor i KQ.

²⁶ *Po aty*, Fondi 14/AP strukturë, viti 1950, dos. 41, fl. 7, Protokoll i mbledhjes së Komitetit të PPSH të rrethit të Gjirokastrës, 17 janar 1950.

shqiptare ndaj minoritetit grek, të cilat modeluan politikën e shtetit shqiptar ndaj minoritetit grek deri në shembjen e komunizmit. Për këtë arsye kjo mbledhje meriton një trajtim të kujdesshëm. Mbledhja u zhvillua pa praninë e Enver Hoxhës. Atë e drejtoi Tuk Jakova, sekretari organizativ i KQ të PPSH²⁷.

Në lidhje me ngjarjen e Glinës, anëtarët e Byrosë Politike ranë dakord se situata në fshatrat e Goricës dhe Glinës, mund të evitohet pasi ishte një gabim i organeve drejtuese lokale. Liri Belishova vuri në dukje në diskutimin e saj, se në këtë rast “puna e armikut nuk ka qenë e mbështetur në fjalë dhe në gjëra abstrakte, por në një fakt konkret, në një gabim tonin, që iu kemi vështirësuar fshatarëve gjendjen e kullotave. Një gjë të tillë [organet lokale] mund ta kishin evituar”²⁸. Gjithashtu, të gjithë anëtarët e Byrosë Politike dënuan veprimin e organeve të policisë dhe sigurimit të shtetit, që në një fshat kaq të vogël kishin bërë arrestime në masë. Sipas fjalëve të tyre, duhej bërë diferencim midis të arrestuarve të Glinës, pra duhet të merreshin masa vetëm ndaj organizatorëve të ngjarjes. “Komiteti i Partisë për fshatin e Glinës, - u shpreh Bedri Spahiu, anëtar i Byrosë Politike, - përveç gabimit të parë që ngushtoi kullotat ka rënë në gabimin e dytë që lejoi të bëhej në një fshat aq të vogël arrestime në masë. Tani populli po ta marrësh në këtë situatë të krijuar është i tëri në pozita armike kundra nesh, pse këtë situatë e ka shfrytëzuar dhe armiku. Komiteti i partisë duhej menjëherë të futej mes popullit pas ngjarjes dhe të përpiquej të gjente fajtorin dhe vetëm ai të futesh në burg dhe jo sikurse u bë tani, gjë që tregon që qeveria nuk është në gjendje të gjejë shkaktarin dhe ka arrestuar kaq njerëz”²⁹.

Ngjarja e Glinës shërbeu si një shtysë për të diskutuar situatën politike dhe ekonomike të minoritetit grek në Shqipëri. Deri në atë kohë, kujdesi kryesor i PPSH ishte të mos lejonte qeverinë greke ta shndërronte minoritetin në bazën e irredentizmit të saj. Ngjarja e Glinës tregoi se kushtet ekonomike të kombinuara me situatën e veçantë dhe delikate në minoritet mund të shkaktonte dhe ndërlikime politike. Kishte ardhur koha

²⁷ *Po aty*, Fondi 14/AP organet udhëheqëse, viti 1950, dos. 20, fl. 18, Nga protokollu i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, 28 janar 1950.

²⁸ *Po aty*, Nga diskutimi i Liri Belishovës në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, 28 janar 1950.

²⁹ *Po aty*, fl. 20, Nga diskutimi i Bedri Spahiut në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, 28 janar 1950.

që qeveria shqiptare, krahas aspekteve arsimore dhe kulturore, të kujdesej edhe për aspekte të tjera të minoritetit grek në Shqipëri.

Të gjithë diskutuesit në mbledhjen e Byrosë Politike vunë në dukje kujdesin me të cilën duhej trajtuar situata me këtë popullsi. Ndryshe nga frazat e bujshme që përdroreshin në fjalimet e drejtuesve të lartë të shtetit, për lidhjen e ngushtë të minoritetit grek me qeverinë komuniste shqiptare “si dje në luftë, ashtu dhe për ndërtimin e socializmit”³⁰, nga diskutimet e anëtarëve të Byrosë Politike duket qartë se ata ishin të ndërgjegjshëm se situata politike në minoritetin grek nuk ishte plotësisht në favor të tyre. Konstatimi i parë i mbledhjes lidhej me situatën politike atje. Në vazhden e patriotizmit të ri që po propagandohej, autoritetet e larta partiake konstatonin se në minoritetin grek nuk njihej sa duhet Bashkimi Sovjetik dhe as vendet e Kampit Socialist. Ata gjithashtu shpreheshin me shqetësim për ndikimin e fortë të “monarko-fashizmit grek dhe imperializmit amerikan”. Shqetësimi i tyre më i madh ishte fakti se me gjithë numrin e madh të komunistëve minoritarë, përsëri PPSH nuk kishte baza të forta. Në minoritet, sipas tyre, nuk zhvillohej lufta e klasave dhe si pasojë nuk luftoheshin “elementët kulakë dhe shovinistë”³¹.

Duke pasur parasysh këtë situatë, Liri Belishova, sekretare e KQ të PPSH, tërhiqte vëmendjen për kujdesin që duhej të kishte me minoritetin pasi “atje është kufi dhe populli është nën influencën amerikane dhe të monarko-fashistëve grekë”³². Në të njëjtën mënyrë e shikonin situatën dhe anëtarët e tjerë të Byrosë Politike, madje kishte disa që vinin në dukje se minoriteti grek ishte i influencuar shumë dhe rryma politike kundërshtarë të PPSH si arkeo-marksizmi³³, të cilat konsideroheshin po aq të dëmshme sa dhe tendencat politike perëndimore.

Anëtarët e Byrosë Politike nuk e vinin në dyshim se në minoritetin grek vepronin kundërshtarët e regjimit komunist, të cilët në mendimin e drejtuesve komunistë shqiptarë ishin armiq të Shqipërisë. Anëtari tjetër i

³⁰ Kjo ishte fraza standarde e të gjithë drejtuesve më të lartë komunistë kur flitej për minoritetin grek.

³¹ *AQSh*, Fondi 14/AP organet udhëheqëse, viti 1950, dos. 20, fl. 20, Protokoll nr. 5 i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të Byrosë Politike të KQ të PPSH, 28 janar 1950.

³² *Po aty*, fl. 18/1, Nga diskutimi i Liri Belishovës në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, 28 janar 1950.

³³ *Po aty*, Nga diskutimet e Beqir Ballukut dhe Bedri Spahiut në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, 28 janar 1950.

Byrosë Politike, Beqir Balluku, kishte qenë i dërguari i KQ në mbledhjen e byrosë së komitetit të PPSH për rrethin e Gjirokastrës, ku ishte diskutuar çështja e Glinës. Ai kishte konstatuar nga afër situatën politike jo të qetë në minoritetin grek, ndikimin e pakët që kishin komunistët shqiptarë atje, si dhe vështirësitë ekonomike me të cilat përballlej kjo popullsi. Ai kishte të njëjtin mendim me Liri Belishovën në lidhje me ndikimet e huaja të fuqishme në minoritet. “Atje, - theksoi ai, - armiku punon me anë parullash, si mundohet të fusë nëpërmjet kufirit spiuna dhe diversantë, atje ka elemente që bëjnë luftë të hapur në fshat. Ka pasur raste që njerëzit largohen bllok nga mbledhja duke i lënë shokët tanë vetëm”³⁴.

Konstatimi i dytë lidhej me gjendjen ekonomike të zonës minoritare. Diskutimet vunë në dukje se minoriteti kishte përfituar nga reformat e deriatëhershme të qeverisë si nga reforma agrare etj, por përsëri gjendja ekonomike ishte problematike. Anëtarët e Byrosë Politike fajësonin autoritetet partiake dhe shtetërore lokale, të cilat “nuk kishin treguar kujdes të veçantë për zhvillimin ekonomik të minoritetit”³⁵. Për të gjithë ishte e qartë se nëse gjendja ekonomike nuk përmirësohej, minoriteti grek mund të shndërrohej në një burim të vazhdueshëm shqetësimi për shtetin shqiptar, por dhe në një pretekst për ndërhyrjen e qeverisë greke. Situata kishte nevojë për masa të shpejta. Lëshimet në fushën e kulturës dhe ruajtjes së identitetit, të cilat i ishin bërë minoritetit grek, duket se nuk mjaftonin. Nëse shqiptarët mund të pranonin të bënin sakrificat dhe të jetonin në kushtet e një ekonomie të racionuar dhe me mungesa të shumta në emër të dashurisë për atdheun, ky argument nuk e bindte dhe aq minoritetin grek. Për më tepër, kur shteti i tyre amë, po përfitonte nga ndihma e SHBA dhe po përpiquej për përmirësimin e standardit të jetesës. Kishte ardhur koha të zbatohesh një tjetër parim marksist “materia përcakton ndërgjegjen”. Qeveria shqiptare dhe PPSH duhet të merrte masa për t’u ëmbëlsuar me minoritetin grek, të paktën me pjesën më të madhe të tij.

Liri Belishova, e cila ishte e para që e mori fjalën në këtë mbledhje, propozoi që të miratohej një vendim mbi masat që do të merreshin për përmirësimin e gjendjes në minoritetin grek. Ky vendim, përveç rrethit të

³⁴ *Po aty*, fl. 19, Nga diskutimi i Beqir Balluku në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, 28 janar 1950.

³⁵ *Po aty*, Fondi 14/AP organet udhëheqëse, viti 1950, dos. 20, fl. 8, Vendim nr. 7 i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi ngjarjet e Glinës të rrethit të Gjirokastrës dhe gjendjen në minoritetin grek, 28 janar 1950.

Gjirokastrës, do t'i dërgohej dhe atij të Sarandës dhe Vlorës³⁶, mesa duket për banorët greqishtfolës të zonës së Nartës. Vendimi përcaktonte qartë politikën e PPSH ndaj minoritetin grek në të gjitha nivelet: politik, ekonomik, shoqëror. Nga ky vendim duket qartë se qeveria komuniste shqiptare ishte mjaft e vendosur për të përfshirë dhe popullsinë minoritare në procesin e krijimit të “njeriut të ri”. Për këtë KQ i PPSH udhëzonte komitetet e Gjirokastrës dhe Sarandës t'i kushtonte “një kujdes të posaçëm forcimit të punës politike në minoritet”³⁷. Kjo donte të thoshte që puna propagandistike në minoritet të zhvillohej dhe më ethshëm se deri atëherë. Madje, vendimi përmbante dhe detaje të veçanta, të cilat tregonin qartazi synimin kryesor të propagandës së PPSH për ideologjizimin e minoritetit grek, si dhe mjetet ndërmjet të cilave do të zhvillohej ajo. Ndër drejtimet kryesore të propagandës ishin: të reklamoheshin më shumë “sukseset e reformave të deritanishme” të kryera nga qeveria komuniste; të popullarizohej Bashkimi Sovjetik dhe Kampi Socialist; si dhe të luftohej influenca e shovinizmit grek dhe ajo e imperializmit amerikan në minoritet³⁸.

Mjetet me të cilat do të arriheshin këto objektiva, sipas vendimit do të ishin të ndryshme. Ato fillonin me forcimin e mjetit më të fuqishëm të propagandës për minoritetin grek, gazetës *Laiko Vima*. Tash e tutje ajo do të kishte drejtues të lartë partiakë, përmbajtje më të kontrolluar nga nivele të larta të PPSH dhe tirazh më të lartë. E gjitha kjo synonte ta çonte propagandën e PPSH te çdo anëtar i minoritetit grek. Mjet tjetër për të zhvilluar propagandën do të ishte dhe shtimi i përkthimeve të literaturës marksiste në gjuhën greke. Për këtë u kërkua të studiohet mundësia e krijimit të një zyre përkthimesh pranë komitetit të partisë së rrethit Gjirokastrë, e cila do të punonte për të përkthyer në greqisht të gjithë materialin që do të shihet i nevojshëm. Ky ishte një moment i përshtatshëm për PPSH, pasi ajo mund të shfrytëzonte për këtë qëllim dhe anëtarët e Partisë Komuniste Greke, të cilët ishin vendosur në Shqipëri pas përfundimit të Luftës Civile.

Po në kuadrin e propagandës për miqësinë shqiptaro-sovjetike u vendos të ngriheshin rrethet kulturore të BS me Shqipërinë. Rretheve të

³⁶ *Po aty.*

³⁷ *Po aty.*

³⁸ *Po aty.*

Gjirokastrës e Sarandës iu kërkua të planifikonin çeljen e ekspozitave nga jeta e BS me diçitura në gjuhën greke.

Në funksion të linjës internacionaliste për bashkim-vëllazërimin e popullit u vendos gjithashtu që “gjuha shqipe si mjet vëllazërimi dhe si gjuhë zyrtare e shtetit shqiptar të bëhet e detyrueshme në shkollat e minoritetit”³⁹.

Një vend të rëndësishëm vendimi i KQ të PPSH ia kushtonte përmirësimit të kushteve ekonomike të minoritetit grek. Në bazë të këtij vendimi, komitetet e PPSH dhe komitetet ekzekutive të rretheve Gjirokastrë dhe Sarandë, në bashkëpunim me Komisionin e Planit të Shtetit u urdhëruan të bënin një studim dhe të hartonin një plan konkret mbi mundësinë e zhvillimit të ekonomisë në minoritet. Si orientim kryesor i politikës ekonomike për këtë zonë u përcaktua zhvillimi i vitikulturës, apikulturës, blegtorisë, artizanatit, hapje kanalesh në Vurg, ndërtim rrugësh automobilistike, ndërtimi i një ujësjellësi në Dropull, ndërtimin e një spitali në Vurg etj.

Krahas masave afatgjatë që synonin drejtimet e zhvillimit ekonomik të këtyre zonave, vendimi parashikonte dhe masa për të kaluar vështirësitë imediate ekonomike me të cilat po përballej kjo popullsi. Organet e pushtetit lokal u urdhëruan të merrnin të gjitha masat për furnizimin e rregullt të krahinave minoritare, “ashtu sikundër është parashikuar edhe për zonat e tjera kufitare”⁴⁰. U vendos njëkohësisht të përkraheshin gratë e reja me fëmijë në moshë të vogël, pleqtë pa krahe pune, duke i furnizuar me bukë për atë pjesë të vitit që nuk e siguronin ushqimin nga tokat e tyre. U ngarkua Ministria e Bujqësisë të merrte në studim çështjen e kullotave për rrethin e Gjirokastrës dhe të caktonte atje aq bagëti sa ishte maksimumi i kapacitetit duke hequr bagëtitë e tepërta, të cilave do t’u sigurohej strehim në rrethe të tjera. Gjithashtu, u vendos të nxiteshin fshatarët e varfër për të marrë më shumë kredi bujqësore, e cila, sipas autoritete partiake, do të përmirësonte ekonominë e tyre⁴¹.

Vendimi nuk linte mënjane dhe masa për integrim më të mirë të brezit të ri minoritar në jetën ekonomike dhe shoqërore të vendit. Në

³⁹ *Po aty*.

⁴⁰ *Po aty*, fl. 20, Nga diskutimi i Tuk Jakovës në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të Byrosë Politike të KQ të PPSH, 28 janar 1950.

⁴¹ *Po aty*, Fondi 14/AP organet udhëheqëse, viti 1950, dos. 20, fl. 8, Vendim nr. 7 i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi ngjarjet e Glinës të rrethit të Gjirokastrës dhe gjendjen në minoritetin grek, 28 janar 1950.

lidhje më këtë u vendos “të tërhiqen sa më tepër të rinj e të reja në shkolla internate, kurse të ndryshme për përgatitje kuadrosh duke u akorduar bursa”⁴². Kjo masë kishte rëndësi të dyfishtë për qeverinë komuniste. *Së pari*, krijonte një rrjet specialistësh vendas për të shërbyer në zonë, të cilët, nga ana tjetër do të zëvendësonin specialistët e shkolluar në Greqi. *Së dyti*, do të ishte një mundësi e mirë për indoktrinimin e masës së të rinjve minoritarë me ideologjinë komuniste.

Vendimi i Byrosë Politike detyronte dhe organet e policisë të lironin pjesën më të madhe të të arrestuarve të ngjarjes së Glinës, duke mbajtur vetëm ata që konsideroheshin si organizatorë. “Një punë e tillë, - theksoi Liri Belishova, - do ta forcojë pozitën tonë, pse populli do të shohë me fakte që jemi përkrahësit e tij dhe me armikun jemi të pamëshirshëm”

Masat për përmirësimin e gjendjes ekonomike të minoritetit grek

Pas vendimit të Byrosë Politike u vunë në veprim dhe organet shtetërore. Më 3 shkurt 1950, Këshilli i Ministrave njoftoi komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit të Sarandës që në zbatim të vendimit të Byrosë Politike të merrte këto masa për të përmirësuar gjendjen e minoritetit grek: “të dërgohen më shumë fëmijë minoritarë për të vazhduar kurse të ndryshme që hapen në qendër; të jepen më shumë kredi agrare për shtresat e varfra minoritare dhe të ndihmohet kjo popullsi për të zhvilluar vitikulturën dhe frutikulturën”⁴³. Ndërsa më 5 shkurt 1950, Këshilli i Ministrave i dërgoi një letër të ngjashme komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të Gjirokastrës. Enver Hoxha në cilësinë e kryeministrit i kërkonte këtij komiteti “... të merret posaçërisht në studim gjendja ekonomike e minoritetit dhe të nxirret konkluzione se ç’mund të bëhet atje për ta përmirësuar gjendjen ekonomike”⁴⁴. Këshilli i Ministrave kërkonte të shikohej, gjithashtu, mundësia e ndërtimit të një ujësjellësi që rrjedh ujin nga Libohova për në Dropullin e Sipërm. Për

⁴² *Po aty*.

⁴³ *Po aty*, Fondi 490, viti 1950, dos. 139, fl. 11, Shkresë e KM drejtuar Komitetit Ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit Gjirokastrë, Sarandë, nr. 538/7, 3 shkurt 1950.

⁴⁴ *Po aty*, fl. 12, Shkresë Kryeministrisë për Komitetin Ekzekutiv të Gjirokastrës, nr. 538/9, 5 shkurt 1950.

këtë do të interesohet dhe Komisioni i Planit të Shtetit dhe Ministria e Punëve Botore⁴⁵.

Relacioni i rrethit të Sarandës mbërriti më 14 mars 1950, ndërsa ai i Gjirokastrës katër ditë më vonë. Relacionet, krahas të tjerave tregonin problematikat e ndryshme me të cilat përballeshin minoritetet në këto dy rrethe, si dhe ndryshimet në gjendjen e tyre ekonomike dhe sociale.

Minoriteti grek i vendosur në fushën e Vurgut të Sarandës vuante mungesa të theksuara të tokës, duke mos arritur të siguronte asnjëherë ushqimin e nevojshëm për familjet. Megjithëse fusha e Vurgut ishte 3225 ha, lumi Bistrica, i cili përshkonte këtë fushë i përmbyste këto toka. Sipas raportit të Sarandës, si pasojë e këtyre përmbytjeve 920 ha tokë qëndronin në ujë gjatë gjithë vitit, ndërsa pjesa tjetër prej 1520 ha që mbetej si tokë e punueshme, ishte vazhdimisht e rrezikuar⁴⁶. Kjo gjendje dëmtonte rëndë ekonominë e 9 fshatrave (Vrion, Metoq, Çuka, Çaus, Aliko, Kasembej, Karalibej, Qenurio. Halo), në të cilat jetonin afro 3500 banorë. Si pasojë e situatës tejet të rënduar, më 1944 fshati Pal ishte detyruar të shpërngulej tërësisht dhe të instalohet në fshatin Kasemallbej⁴⁷. Komiteti Ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit të Sarandës mendonte se “bonifikimi i këtij lumi do të përmirësonte në një shkallë të gjerë ekonominë e këtyre fshatrave minoritare dhe të krejt rrethit, nga ana tjetër kjo do të bëhej një fushë pjellore për kultivimin e kulturës së orizit që e prodhon mjaft vendi, për bimë industriale dhe për zhvillimin e agrumeve”⁴⁸.

Gjithashtu komiteti ekzekutiv i rrethit të Sarandës kërkonte ndërtimin e kanalit të Ymerefendisë, i cili do të shërbente për shtimin e prodhimit të misrit, orizit dhe bimëve industriale “në një fushë të madhe prej 100 ha të fshatrave Kranë-Ymerefendi-Hardhasovë-Jermë-Tremul”, që përbëhen prej 2000 frymësh⁴⁹.

Duket se për popullsinë minoritare greke që jetonte në rrethin e Sarandës gjendja ishte e vështirë dhe pak masa ishin marrë për ta përmirësuar atë. Në kërkesat e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të

⁴⁵ *Po aty*, Fondi 490, viti 1950, dos. 139, fl. 11, Shkresë e KM drejtuar Komitetit Ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit Gjirokastër, Sarandë, nr. 538/7, 3 shkurt 1950.

⁴⁶ *Po aty*, Fondi 490, viti 1950, dos. 1765, fl. 2, Relacioni i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit Sarandë për përmirësimin e gjendjes në minoritet.

⁴⁷ *Po aty*.

⁴⁸ *Po aty*.

⁴⁹ *Po aty*.

rrethit Sarandë ishin përfshirë edhe fonde për ndihmë në rindërtimin e shtëpive (qeveria shqiptare e kishte deklaruar këtë fazë të rindërtimit të mbyllur që në vitin 1947). Gjithashtu komiteti ekzekutiv i rrethit të Sarandës kërkonte dhe ndërtimin e dy shkollave unike për minoritetin: në Finiq dhe në Hoxhë.

Kërkesat që vinin nga komiteti ekzekutiv i rrethit të Gjirokastrës tregonin se minoriteti në këtë zonë i kishte tejkaluar vështirësitë e mbijetesës dhe kërkonte të vinte themelet për një jetesë më të mirë në të ardhmen. Së pari, komiteti ekzekutiv i rrethit të Gjirokastrës kërkonte mundësinë e zhvillimit të një lloj industrie, e cila do të ulte papunësinë në rajonet minoritare greke, veçanërisht në një masë të madhe grash, të cilat nuk zotërojnë tokë, “pasi meshkujt janë në mërgim”. Për këtë u kërkua që të ngriheshin punishte artizanati për përpunimin e leshit në Dervicë dhe Bularat, për qëndisima në Vanistër etj.

Autoritetet shtetërore të rrethit të Gjirokastrës i propozonin qeverisë t'i kushtonte rëndësi zhvillimit të apikulturës dhe frutikulturës, veçanërisht në Dropullin e Sipërm dhe në Rrëzën e Zezë. Ndërsa për Dropullin e Poshtëm ata mendonin se “i duhej dhënë rëndësi më e madhe dhe një ndihmë më efikase mëkëmbjes së kësaj krahine, pasi nga njëra anë fusha e kësaj krahine është mjaft pjellore me bujq përparimdashës dhe punëtorë dhe nga ana tjetër është e vetmja krahinë pa pyje, pa pemë frutore dhe në përgjithësi vendi [ishte] i thatë [pa ujë]”⁵⁰. Për këtë zyrtarët lokalë kërkonin investime të qeverisë për pyllëzimin e zonës, krijimin e infrastrukturës për kultivimin e krimbit të mëndafshit, mbjelljen e vreshtave, si dhe dhënien e investimeve të nevojshme për zhvillimin e zooteknikës.

Të gjitha këto investime, të cilat kërkoheshin herë nga fondet shtetërore e herë në formë kredie e huaje kapnin shumën e përgjithshme prej 205.000 lekësh. Përveç këtyre, kërkoheshin investime për fermën shtetërore të Goranisë në Dropullin e Poshtëm dhe fonde për sigurimin e ujit për ujitje, si dhe një investim prej 5.000.000 lekësh për sigurimin e ujit të pijshëm në Dropullin e Poshtëm. Shifrat tregojnë se investimet që kërkoheshin për Dropullin e Poshtëm ishin dy ose tre herë më të mëdha se ato në pjesën tjetër të minoritetit. Nuk mund të gjykojmë nëse kjo ishte

⁵⁰ *Po aty*, Fondi 490, viti 1950, dos. 1765, fl. 4, Relacion i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit Gjirokastrë për përmirësimin e gjendjes në minoritet, 18 mars 1950.

diktuar nga nevojat e kësaj popullsie, apo nga qëndrimi politik i saj. Popullsia e Dropullit të Poshtëm ishte treguar më e bindur ndaj regjimit komunist. Në propagandën partiake e shtetërore, minoriteti grek në Shqipëri u identifikua kryesisht me fshatrat minoritare të Dropullit të Poshtëm.

Pasi u morën mendimet nga komitetet ekzekutive të rretheve Gjirokastër dhe Sarandë, Këshilli i Ministrave vuri në lëvizje të gjitha dikasteret përkatëse për plotësimin e kërkesave të tyre. Kryeministri Enver Hoxha e ndiqte dhe e kontrollonte të gjithë këtë proces nga afër. Ai lëshoi një sërë urdhrash, të cilat synonin përmirësimin e situatës ekonomike në zonat ku jetonte minoriteti grek. Ato synonin kryesisht në dy drejtime kryesore:

Së pari, të lehtësonin në mënyrë të shpejtë situatën ekonomike të atyre zonave që po vuanin mungesa të ushqimeve. Më 2 mars 1950, kryeministria pranoi propozimin e Komitetit të Grumbullimeve për të ndihmuar krahinën e Rrëzës së Zezë, duke i falur asaj tatimin e vitit 1949, prej 1566 kv. misër⁵¹. Ky fond përbënte të njëjtën sasi që ishte dëmtuar për shkak të thatësirës⁵². Po kështu, i njofton Komitetit Ekzekutiv se duhet të dërgojë në fshatrat e minoritetit një mjek, i cili do të shërbejë në këto zona 3-4 herë në javë, por pa u shkëputur nga ambulanca. Ndërkohë që urdhërohet ky komitet të merren masa që kjo zonë të ketë një ambulancë dhe një infermier të përhershëm⁵³.

Së dyti, të vinin në punë mekanizmat shtetërorë për përmirësimin afatgjatë të ekonomisë në zonat minoritare. Qeveria shqiptare, siç duket nga këto urdhëresa, kishte vendosur t'i jepte zonës ku banonte minoriteti grek, drejtim kryesisht bujqësor. Kjo diktohej jo vetëm nga traditat ekonomike të kësaj zonë, por edhe nga fakti që krahina ishte kufitare⁵⁴. Kështu, një sërë shkresash iu dërguan Ministrisë së Financave dhe asaj të Bujqësisë. Atyre iu kërkohej të akordoheshin fondet e duhura për të mbjellë të bërë pyllëzimin e zonës. Fonde të tjera u kërkuar për zhvillimin e apikulturës, vreshtarisë, rritjen e krimbit të mëndafshit,

⁵¹ *Po aty*, Fondi 490, viti 1950, dos. 139, fl. 18, Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 112, 2 mars 1950.

⁵² *Po aty*, fl. 14, Shkresë e Komitetit të Grumbullimeve për KM, nr. 10/85, 14 shkurt 1950.

⁵³ *Po aty*, fl. 1, Shkresë e Ministrisë së Shëndetësisë për Komitetin Ekzekutiv të kp të rrethit të Gjirokastrës, 13 shkurt 1950.

⁵⁴ Qeveria komuniste, për shkak të frikës nga armiqtë e jashtëm, e kishte instaluar industrinë kryesisht në rajonet e brendshme të vendit, larg zonave kufitare.

kanalizime të tokave bujqësore⁵⁵. Këshilli i Ministrave kërkonte mendimin e ministrisë së Financave, nëse mund t'i akordoheshin bujqve minoritarë kredi agrare për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të mësipërme. Ministria e Financave nuk kishte asnjë kundërshtim dhe iu përgjigj pozitivisht në lidhje me këtë⁵⁶. Gjithashtu, Komisioni i Planit të Shtetit u urdhërua t'i akordonte fonde komitetit ekzekutiv të rrethit Gjirokastrës për të ndërtuar një ujësjellës për Dropullin duke e sjellë ujin nga Libohova⁵⁷.

Ajo që të bën përshtypje në këto urdhëresa është koha e shkurtër që i lihet në dispozicion institucioneve shtetërore për të marrë këto masa. Afati për zbatimin e këtyre urdhrave ishte më pak se një muaj. Pyetja që lind natyrshëm është pse ky nxitim i madh i shtetit komunist shqiptar? Cili ishte synimi i tij në ndërmarrjen kaq të beftë të projekteve, të cilat, përveç të tjerave, kërkonin dhe një sasi jo të vogël parash?

Krahas arsyeve që u analizuan më herët në këtë artikull, kishte dhe dy arsye të tjera. Arsyeja e parë lidhet me zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin Popullor, të cilat do të mbaheshin në muajin qershor. Mendoj se qeveritarët shqiptarë kërkonin që minoriteti të kuptonte me vepra se qeveria komuniste, po merrte masa për përmirësimin e gjendjes së tij ekonomike. Në këtë mënyrë, ata shpresonin të mos përsëritej rezultati i zgjedhjeve për këshillat popullore të një viti më parë.

Arsyen e dytë na e dëshmojnë urdhëresat e Këshillit të Ministrave. Me anë të përmirësimit të kushteve ekonomike të minoritetit, drejtuesit komunistë kërkonin të merrnin një masë të re, atë të ndërprerjes së pakove që minoritarët grekë merrnin nga familjarët e tyre në emigracion. PPSH i kishte konsideruar vazhdimisht këto dërgesa "si mbështetje për të zhvilluar një punë politike indirekte në favor të tij [imperializmit amerikan]. Enver Hoxha më 15 shkurt 1950 i kërkon mendim Ministrisë së Financave dhe asaj të Tregtisë nëse do të ishte i mundur kufizimi i

⁵⁵ *AQSh*, Fondi 490, viti 1950, dos. 1765, fl. 8, Shkresë e Këshillit të Ministrave për Ministrinë e Financave dhe për njoftim Ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve, nr. 538/22, 21 prill 1950.

⁵⁶ *Po aty*.

⁵⁷ *AQSh*, Fondi 490, viti 1950, dos. 139, fl. 10, Shkresë e Këshillit të Ministrave për Komisionin e Planit të Shtetit, 12 shkurt 1950.

pakove me ushqime dhe veshmbathje që i vijnë popullit minoritar në përgjithësi nga SHBA⁵⁸.

Nga analiza e përgjithshme e situatës së brendshme e të jashtme të shtetit shqiptar në fillim të viteve '50, mund të arrijmë në konkluzionin se minoriteti grek siguroi disa lëshime, por pati dhe mangësi të caktuara. Me gjithë kufizimet ideologjike, lëshime të shumta iu bënë minoritetit grek për ruajtjen e identitetit të tij kombëtar. Integrimi i minoritetit grek në jetën politike e shoqërore ishte shndërruar prej kohësh në një linjë politike të shtetit shqiptar⁵⁹. Vendimi i Byrosë Politike i 28 janarit 1950, e vendosi minoritetin grek nën kujdesin e veçantë të shtetit edhe në fushën ekonomike. Falë tij, minoriteti grek arriti të siguronte një standard jetese më të lartë, madje edhe se pjesa tjetër e popullsisë shqiptare.

Në “këmbim” të këtij kujdesi në lëmin ekonomik, atij iu desh të vuajë disavantazhin e një kontrolli të vazhdueshëm të organeve të diktaturës dhe izolimin e tejskajshëm. Ndonëse kjo ishte një situatë e përgjithshme, nga e cila vuante dhe pjesa tjetër e popullsisë shqiptare, mendoj se minoriteti grek e ka përjetuar më thellë, për shkak të mungesës së kontakteve me trungun e tyre etnik dhe kulturor.

S u m m a r y

GREEK MINORITY IN ALBANIA IN EARLY '50-s

After the end of the civil war in Greece with the victory of the right and with the dissociation of Yugoslavia from the Eastern Block, Albania became the first barricade, the extreme frontier between the West and the East, obtaining thus a great strategic importance. Under this situation, the Greek minority, which was spread in the border area between Albania and Greece, acquired great importance.

The article tries to analyze the influence of the international situation on the politics of the Albanian government concerning the Greek minority in the beginning of the '50s. It argues that the Greek minority in Albania succeeded to obtain some concessions, while suffering from some lacks. Notwithstanding the ideological

⁵⁸ *Po aty*, fl. 14, Shkresë e Këshillit të Ministrave për Ministrinë e Financave dhe për njoftim dhe Ministrisë së Tregtisë, nr. 538/5.

⁵⁹ Për më tepër mbi lëshimet e shtetit shqiptar në integrimin e tij në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit, si dhe për lëshimet në fushën e identitetit shiko: Sonila Boçi, “Politika e shtetit komunist shqiptar ndaj minoriteteve në Shqipëri (1944-1948)”, në *Studime historike*, 1-2/2010, f. 116-117.

censuring, the Greek minority enjoyed numerous concessions aiming the preservation of its national identity. The integration of the Greek minority inside the political and social life had become main policy for the Albanian government. The decision of the Political Bureau on January 28, 1950, placed the Greek minority under the particular attention of the government in the economic field, as well, offering a higher standard of living, often higher than the rest of the population.

The article emphasizes that, as an 'exchange' for this attention on the economic and social field, the Greek minority had to face the disadvantage of a continuous control by the instances of the dictatorship and suffer from a complete isolation. Even if this was a general policy that the rest of the population had to face as well, I believe that the Greek minority has endured this situation in a deeper manner, due to the lack of communication with their cultural and ethnic pedigree.

